

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5398
E premte, 9 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Quinti mirëpret
tërheqjen e liderëve nga
iniciativa për shfuqizimin
e Speciales ■ PAGE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAVIT JASHARI ■ PAGE 4-5

Specialja të shfuqizohet



Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, është shprehur i zhgënjyer me tërheqjen e liderëve shtetërorë nga iniciativa për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jashari i ka bërë thirrje kryeministrit Ramush Haradinaj ta procedojë për në Kuvend shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale, pastaj kryeparlamentari Kadri Veseli ta shtyjë përpara këtë proces. Ai ka pohuar se nëse Specialja rikthehet në Kuvend, deputetët do të votojnë për shfuqizimin e saj. Jashari ka thënë se liderët shtetërorë duhet ta mbrojnë interesin nacional duke i dhënë vendin meritot luftës së UÇK-së

AKTUALE

ADEM DEMAÇI, NDËR
PERSONALITETET
MË ME FAT NË
HISTORINË MË TË RE
TË KOSOVËS F. 11



Selatin NOVOSELLA

KËSHILLTARI I TRUMPIT
KONFIRMON PËRKRAHJEN
PËR KOSOVËN F. 2

IKSHP-ja REKOMANDON
QË NXËNËSIT ME SIMPTOMA
TË GRIPIT TË QËNDROJNË NË
SHTËPI F. 6

EKONOMI

PUNËTORËT E KEK-ut
KËRKOJNË RITJE TË PAGAVE F. 9

MINISTRI HASANI PREMTON
3.5 MILIONË EURO INVESTIME
NË MALISHEVË F. 8

KULTURË

SKËNDERBEU
DHE MARIN
BARLETI F. 13



Feride PAPLEKA

SPORT

FLAMURI I KOSOVËS
U NGRE NË PYEONGCHANG,
SOT PARAKALIMI HISTORIK F. 16

Qytetarët kërkojnë përfshirjen e ShBA-së në dialog

Pas liderëve politikë, edhe shumica e qytetarëve të Kosovës kanë kërkuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të ShBA-së në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Kjo kërkesë e qytetarëve ka dalë nga hulumtimi i pestë i

KDI-së mbi opinionin publik lidhur me dialogun Kosovë - Serbi, sipas të cilit, rreth 49 për qind e qytetarëve mendojnë se dialogu Kosovë - Serbi nuk duhet të vazhdojë pa përfshirjen e ShBA-së ■ PAGE 3



Urgjentisht kërkohet të intervenohet në Kompleksin Memorial 'Adem Jashari' ■ PAGE 7

RENOVA
Mazgimi
Xhegjihtë-Telovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Produkt of EPS and XPS
Mob: +377(0) 44 506 815
Toll-Free: +381(0) 29 246 030
E-mail: vat_sps@satstyro.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Këshilltari i Trumpit konfirmon përkrahjen për Kosovën


Këshilltari i presidentit të ShBA-së për siguri kombëtare, Herbert Raymond McMaster, gjatë pjesëmarrjes së tij me rastin e dhjetëvjetorit të pavarësisë të organizuar nga Ambasada e Kosovës në Uashington, ka theksuar se ShBA-ja do të vazhdojë të jetë bashkë me Kosovën në rrugën e saj të forcimit të institucioneve demokratike

"Epoka e re"

WASHINGTON, 8 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Kosovës në Uashington, me rastin e dhjetëvjetorit të pavarësisë. Në pritje morën pjesë edhe presidenti Hashim Thaçi, këshilltari i presidentit të ShBA-së për siguri kombëtare, Herbert Raymond McMaster, zëvendësndihmësekretarja amerikane Laura Cooper, drejtori për Çështjet e Evropës Jugore dhe Qendrore, Matthew Palmer, përfaqësues të misioneve diplomatike në ShBA dhe bashkatdhetarë.

Kryeministri Haradinaj ka thënë në fjalën e tij se pavarësia e Kosovës është arritur në përpjekje të përbashkëta me ShBA-në dhe kjo e bën më të veçantë lidhjen mes dy popujve. Ai ka pohuar se ShBA-ja në krye të NATO-s ka shpëtuar jetët e qytetarëve të Kosovës. "Është kjo një miqësi e posaçme dhe për këtë jemi krenarë", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Në adresimin e tij, këshilltari i presidentit Trump për sigurinë kombëtare, H. R. McMaster, duke i vlerësuar të arriturat e Kosovës në dhjetëvjetorin e pavarësisë, ka theksuar se ShBA-ja do të vazhdojë të jetë bashkë me Kosovën në rrugën e saj të forcimit të institucioneve



demokratike, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në forcimin e sundimit të ligjit dhe të rendit

dhe në zhvillimin ekonomik që do ta ulë shkallën e papunësisë. Ai ka thënë se ShBA-ja do të jetë

përkrah Kosovës edhe në proceset e konsolidimit ndërkombëtar të saj.



Kryeparlamentari Veseli takon komunitetin shqiptar në Kroaci

ZAGREB, 8 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ambasadori i Kosovës në Zagreb, Gëzim Kasapolli, ka takuar të enjten përfaqësuesit e bashkësisë shqiptare në Kroaci. Në këtë takim, kryeparlamentari Veseli u njoftua nga përfaqësuesit e komunitetit shqiptar për të arriturat e tyre dhe për mundësitë e lidhjes më të madhe mes tyre dhe institu-

cioneve të Kosovës në të gjitha fushat.

Kreu i Kuvendit të Kosovës i njoftoi përfaqësuesit e bashkësisë shqiptare për të arriturat e Republikës së Kosovës dhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit me shtetin kroat, për t'u krijuar qytetarëve të Kosovës që jetojnë në Kroaci mundësi të reja si në fushën e arsimit, po ashtu edhe në integrim në të madh në institucionet

kroate. "Biseduam për fuqizimin e lidhjeve midis institucioneve të Kosovës me qytetarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në Kroaci. Komuniteti shqiptar në Kroaci është i fuqishëm ekonomikisht dhe punëson mijëra punëtorë. Ata shprehën gatishmërinë të gjejnë mënyra që bizneset e tyre t'i shtrijnë edhe në Kosovë", ka thënë Veseli pas takimit me përfaqësuesit e bashkësisë shqiptare në Kroaci.

Hoxhaj në Parlamentin Evropian: Pa viza dialogu është i pakuptimtë

STRASBURG, 8 SHKURT (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, po qëndron për vizitë në Strasburg të Francës, ku ka zhvilluar takime të shumta me deputetë të Parlamentit Evropian.

Në takimet me eurodeputetë, Hoxhaj ka deklaruar se dialogu me Serbinë varet nga liberalizimi i vizave për Kosovën. Sipas tij, nëse nuk bëhet liberalizimi i vizave për Kosovën, vazhdimi i dialogut me Serbinë nuk do të ketë më kuptim. "Nëse Serbia është shpërblyer shumëfish për shkak të dialogut me Kosovën, edhe Kosova duhet të shpërblehet në mënyrë të balancuar në këtë drejtim. Prandaj, nëse Kosova nuk merr liberalizimin pasi t'i kryejë detyrat brenda vitit 2018, këtij dialogu do t'i humbasë kuptimi, jo vetëm në planin politik, por edhe atë të mbështetjes së qytetarëve", ka theksuar Hoxhaj.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka takuar kryetarin e Komitetit për Politikë të Jashtme (AFET), David McAllister, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen ndaj Kosovës sa i përket liberalizimit të vizave, ndërsa ka kërkuar mbështetjen e

tij që, pasi Kosova t'i kryejë detyrat e saj të brendshme, të krijohet një momentum brenda Parlamentit Evropian, që liberalizimi i vizave t'u jepet qytetarëve të Kosovës brenda vitit 2018.

Për këtë temë Hoxhaj ka diskutuar edhe me mbështetësen e madhe të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, eurodeputeten Tanja Fajon, si dhe eurodeputetin slovak Eduard Kukan. "U kam kërkuar mbështetje në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, pasi një gjë e tillë nënkupton integrimin individual të çdo qytetari të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe është e drejtë fundamentale e qytetarëve të lëvizin lirshëm në Evropë", është shprehur Hoxhaj.



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar rezultatet e sondazhit të pestë "Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi, këndvështrimi i qytetarëve"

Qytetarët kërkojnë përfshirjen e ShBA-së në dialog

Pas liderëve politikë, edhe shumica e qytetarëve të Kosovës kanë kërkuar përfshirjen e drejtpërdrejt të ShBA-së në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Kjo kërkesë e qytetarëve ka dalë nga hulumtimi i pestë i KDI-së mbi opinionin publik lidhur me dialogun Kosovë - Serbi, sipas të cilit, rreth 49 për qind e qytetarëve mendojnë se dialogu Kosovë - Serbi nuk duhet të vazhdojë pa përfshirjen e ShBA-së

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 SHKURT - Qytetarët e Kosovës e duan përfshirjen e drejtpërdrejt të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në dialogun për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Këtë e ka treguar një hulumtim i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) lidhur me këtë çështje.

Jeta Krasniqi nga KDI-ja, e cila i ka prezantuar të gjeturat e këtij hulumtimi, ka thënë se rreth 49 për qind e qytetarëve mendojnë se ky dialog nuk duhet të vazhdojë pa përfshirjen e drejtpërdrejt të ShBA-së. "49 për qind e qytetarëve të anketuar mendojnë se dialogu Kosovë - Serbi nuk duhet të vazhdojë nëse nuk do të ketë përzjerje direkte të ShBA-së në këtë proces, 30 për qind e qytetarëve janë shprehur pro vazhdimin të dialogut me Serbinë edhe nëse nuk do të ketë përfshirje direkte të ShBA-së, kurse 21 për qind janë shprehur se nuk e dinë nëse duhet të vazhdojë apo jo dialogu pa përfshirjen e ShBA-së", ka thënë Krasniqi. Sipas hulumtimit, qytetarët e komunitetit serb mendojnë ndryshe. "Janë 45 për qind e të anketuarve nga komuniteti serb që ndajnë qëndrimin se dialogu

duhet të vazhdojë edhe pa përfshirjen e ShBA-së në këtë proces, kundrejt vetëm 29 për qind të qytetarëve nga komuniteti shqiptar dhe 24 për qind nga komunitetet e tjera të cilët mendojnë të njëjtën gjë", ka thënë Krasniqi. Ajo ka theksuar se, bazuar në këtë sondazh, mbi gjysma apo 51 për qind e qytetarëve të anketuar nuk presin që procesi i dialogut me Serbinë të përmbyllet gjatë vitit 2018.

Qëndrim të ngjashëm, sipas saj, ndajnë të gjithë qytetarët, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike. Krasniqi ka bërë me dije se rreth gjysma e qytetarëve të anketuar (48 %) janë përgjigjur se nuk presin njohje nga Serbia në përfundim të procesit të dialogut. "Vetëm 1 për qind e qytetarëve të komunitetit serb presin që Serbia do ta njohë shtetin e Kosovës në përfundim të këtij procesi, krahasuar me 34 për qind të qytetarëve të komunitetit shqiptar dhe 23 për qind të qytetarëve të komuniteteve të tjera", është shprehur ajo.

Kurse Egzon Osmanaj nga KDI-ja ka theksuar se një përqindje shumë e lartë e qytetarëve, përkatësisht 67 për qind e tyre, mendojnë se marrëveshjet e reja me Serbinë duhet të diskutohen në Kuvend para



nënshkrimit të tyre në Bruksel. "Ndërsa janë 71 për qind e komunitetit shqiptar dhe 56 për qind e komuniteteve të tjera që ndajnë këtë qëndrim. Vetëm 20 për qind e komunitetit serb vlerëson se Kuvendi duhet të luajë këtë rol", ka treguar Osmanaj. Po ashtu, ai ka bërë me dije se janë 50 për qind e qytetarëve që mendojnë se dialogu i Brukselit nuk ka arritur t'i

përmirësuar marrëdhëniet Kosovë - Serbi.

Këtë qëndrim, sipas Osmanajt, e ndajnë pjesa më e madhe e qytetarëve nga komuniteti shqiptar dhe komunitetet e tjera. "Qytetarët e komunitetit serb, përkatësisht 47 për qind e tyre, nuk e dinë se çfarë pasojash ka pasur dialogu në marrëdhëniet në mes dy shteteve", është shprehur Osmanaj.

Kohë me parë edhe krerët institucionalë, presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë kërkuar që në fazën e fundit të këtij procesi të dialogut të përfshihet edhe ShBA-ja. Madje presidenti ka bërë me dije se ka marrë konfirmimin nga zëvendës-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mike Pence, se ky shtet do të bëhet pjesë e këtij procesi.

Hahni: Marrëveshja midis Beogradit e Prishtinës është ende letër e zbrazët



PRISHTINË, 8 SHKURT - Marrëveshja ligjërisht e detyrueshme midis Serbisë dhe Kosovës është aktualisht një letër e zbrazët, ka thënë në Beograd komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn.

Në konferencën "Strategjia për Ballkanin Perëndimor - hapja e rrugës për anëtarësim në BE", Hahni ka theksuar se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve, miratimin e së cilës BE e kërkon para anëtarësimit të Serbisë në bllok, do të varet nga rrjedha e dialogut. "Kjo marrëveshje tash për tash është një copë letre e bardhë. Nuk dua të paragjykoj, por është e rëndësishme që dy palët të

gjejnë zgjidhje që çojnë kah dokumenti i detyrueshëm që ne e kërkojmë", ka thënë Hahn. Ai ka pohuar se strategjia e re e BE-së për zgjerim me Ballkanin Perëndimor thekson se për anëtarësimin e Serbisë në bllok duhet të plotësohen të gjitha kushtet, sidomos kur bëhet fjalë për sundimin e ligjit dhe normalizimin e marrëdhënieve me Prishtinën. Hahni ka shtuar se strategjia jep perspektivë të qartë evropiane edhe për Kosovën. "Duhet të shihet si një motiv edhe për Kosovën që të punojë me Serbinë në një dokument ligjërisht detyrues dhe t'i normalizojë marrëdhëniet", ka thënë Hahn.

Flet për "Epokën e re", Xhavit Jashari

Specialja të shfuq

Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, është shprehur i zhgënjyer me tërheqjen e liderëve shtetërorë nga iniciativa për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Ai ka thënë se një gjë e tillë është jonjerëzore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jashari i ka bërë thirrje kryeministrit Ramush Haradinaj ta procedojë për në Kuvend shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale, pastaj kryeparlamentari Kadri Veseli ta shtyjë përpara këtë proces. Ai ka pohuar se nëse Specialja rikthehet në Kuvend, deputetët do të votojnë për shfuqizimin e saj. Jashari ka thënë se liderët shtetërorë duhet ta mbrojnë interesin nacional duke i dhënë vendin meritort luftës së UÇK-së

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 SHKURT -

"Epoka e re": Z. Jashari, pavarësisht prej kërkesës së shoqatave të luftës, përkatësisht petitionit të mijëra qytetarëve dhe iniciativës së 40 deputetëve, nuk ndodhi miratimi i Ligjit për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Si e komentoni tërheqjen e liderëve shtetërorë nga kjo iniciativë?

Jashari: Tërheqja nga iniciativa për shfuqizimin e Gjykatës Speciale është e pamoralshme dhe jonjerëzore. Drejtësia ndërkombëtare në vazhdimësi është marrë me akuzat të shpifura dhe në asnjë rast nuk është faktuar se pjesëtarët e UÇK-së kanë bërë krime ndaj popullatës civile. Nuk mund të vazhdohet edhe më tutje me të gjitha këto padrejtësi që po i bëhen luftës së UÇK-së dhe pjesëtarëve të saj. Konsideroj se Gjykata Speciale është padrejtësi e radhës, pra pas UNMIK-ut, EULEX-it. Që të tria këto kanë ardhur me pretendime politike të orkestruara nga Serbia dhe aleatët e saj. Institucionet shtetërore të Kosovës në radhë të parë duhet t'i japin vendin meritort luftës së UÇK-së. Të gjitha që kanë çuar dorë për të themeluar këtë gjykatë dhe ata që heqin dorë nga shfuqizimi i Gjykatës Speciale kanë bërë padrejtësi të madhe ndaj luftës së UÇK-së, vlerës më kulmore të popullit shqiptar. UÇK-ja është e popullit dhe luftën e ka bërë për lirinë e popullit. Prandaj i ftoj deputetët e Kuvendit të mos e

keqpërdorin besimin që ua ka dhënë populli. Po ashtu, i bëjë thirrje kryeministrit ta procedojë këtë çështje për në Kuvend, pastaj kryeparlamentari ta shtyjë përpara. Nëse kjo çështje rikthehet në Kuvend, besojmë shumë se deputetët do të votojnë për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Është absurd për Kosovën të themelohet një gjykatë e tillë, kurse për Serbinë jo, edhe pse dihet botërisht se ajo ka kryer krime, masakra dhe gjenocid mbi shqiptarët. Bartësit e institucioneve duhet t'i thërrasin mendjes, në mënyrë që të mos lejojnë edhe më tutje të luhet me vlerën kulmore të popullit shqiptar siç është lufta e UÇK-së. Nuk kemi nevojë për një gjykatë të tillë përderisa është faktuar se lufta jonë ka qenë e drejtë edhe në Tribunalin e Hagës me Ramush Haradinaj, me Fatmir Limaj dhe të tjerët. Të gjithë ata që kanë ardhur në Kosovë në emër të drejtësisë kanë bërë padrejtësi. Nëse kanë nevojë këta liderët e institucioneve apo kushdo tjetër që mendon se na duhet një gjykatë e tillë i ftoj t'i vizitojnë varrezat në çdo komunë dhe të shohin se sa qytetarë të pafajshëm janë vrarë dhe të shohin se sa masakra janë kryer mbi popullatën civile. Liderët shtetërorë duhet ta mbrojnë interesin nacional. Nuk mund të punohet në këtë drejtim pa i dhënë vendin meritort luftës së UÇK-së.

"Epoka e re": Ndihehi të mashtruar nga presidenti Thaçi, kryeparlamentari Veseli



e kryeministri Haradinaj, të cilët fillimisht e mbështeten këtë iniciativë e pastaj u tërhoqën?

Jashari: Kjo lë të mbetet në ndërgjegjen e gjithë atyre që sot janë në institucione. Qëndrimet e tyre tregojnë gatishmërinë e tyre për të qenë servilë ndaj ndërkombëtarëve, ndaj atyre që të vetmin qëllim kanë ta denigrojnë luftën e UÇK-së përmes gjykatave të padrejta. Ndërkombëtarët e tentojnë ta barazojnë luftën e

drejtë dhe të pastër të UÇK-së me krimin, masakrat dhe gjenocidin që ka kryer Serbia në Kosovë. Të gjitha akuzat ndaj luftës së UÇK-së janë të inskenuara nga politika serbe me mbështetjen ndërkombëtare. Pavarësisht se si do të rrjedhin gjërat, pra nëse Kuvendi do ta miratojë ose jo Ligjin për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, ne kemi qenë, jemi dhe do të jemi çdoherë kundër kësaj gjykate dhe kundër çdo gjeje që ka për qëllim

ta kriminalizojë luftën e drejtë të UÇK-së.

"Epoka e re": Çfarë do të bëni nëse institucionet nuk do të merren me këtë iniciativë?

Jashari: Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së do të konsultohen me organet e tyre dhe nuk do të rrinë duarkryq. Lejimi i një gjykate të tillë shkel sovranitetin e popullit, gjymtyrët e invalidëve dhe gjakun e dëshmorëve. Si ka mundësi të krijohet një gjykatë për

izohet

që nuk i japin vendin meritort luftës së UÇK-së.

"Epoka e re": Do të thotë ju si organizata ende nuk keni hequr dorë nga iniciativa për shfuqizimin e Speciales?

Jashari: Pavarësisht prej deklaratave të liderëve shtetërorë, ne qëndrojmë fuqishëm në kërkesat tona. E kemi kundërshtuar dhe kemi protestuar në forma të ndryshme kundër kësaj gjykatë, si dhe do të vazhdojmë ta kundërshtojmë deri në fund. Drejtuesve të institucioneve, qoftë presidentit, kryeparlamentarit dhe kryeministrit, u bëjmë thirrje t'i kryejnë detyrat dhe obligimet që i kanë marrë nga qytetarët. U bëjmë thirrje të mos bien pre e politikës ditore. Ne e dimë se të gjitha këto po ndodhin me kërkesën e Serbisë dhe aleatëve të saj. Institucionet tona duhet të punojnë që kriminelet serbë të dalin para drejtësisë, e jo të nulloset lufta e UÇK-së. Në radhë të parë duhet të jetë interesi nacional.

"Epoka e re": Shtetet që e kanë mbështetur Kosovën, iniciativën për shfuqizimin e kësaj gjykatë e kanë vlerësuar të panevojshme dhe si tendencë për izolim të Kosovës. Madje vendet e Quintit të enjten kanë mirëpritur tërheqjen e liderëve nga kjo iniciativë.

Jashari: Ne u jemi mirënjohës të gjithë atyre që e kanë mbështetur dhe ndihmuar luftën e UÇK-së dhe Kosovën, në radhë të parë u jemi mirënjohës atyre që me gjakun dhe gjymtyrët e tyre e kanë sjellë lirinë e atdheut. Kosova vazhdon të jetë e izoluar sepse ata që i udhëheqin institucionet nuk kanë qenë si duhet në kryerjen e detyrave. Këto institucione nuk kanë nxjerrë asnjë rezolutë për asnjë prej masakrave që janë bërë në Kosovë, siç është ajo e Reçakut, e Mejës, e Izbicës dhe shumë e shumë masakrave të tjera. Nuk kanë bërë asgjë që kryerësit e këtyre masakrave të vendosen para drejtësisë. U bëj thirrje të mos vazhdojnë tutje degradimin e luftës së UÇK-së dhe interesit të përgjithshëm, sepse interesi kombëtar është më i rëndësishëm se ai personal e partiak. Prandaj ata duhet të punojnë për interesin kombëtar, në të kundërtën nuk do të arrijmë atje ku kemi synuar. Institucionet e kanë obligim ta çojnë në vend amanetin e dëshmorëve.

Quinti mirëpret tërheqjen e liderëve nga iniciativa për shfuqizimin e Speciales

Vendet e Quintit, Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe ShBA-ja, kanë mirëpritur deklaratat e fundit të udhëheqësve politikë të Kosovës dhe zotimet e tyre se heqin dorë nga përpjekjet për ta shfuqizuar Gjykatën Speciale

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 SHKURT - Ambasada e Francës, e Gjermanisë, e Italisë, e Mbretërisë së Bashkuar dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet një reagimi të përbashkët për medie, kanë mirëpritur deklaratat e fundit të udhëheqësve politikë të Kosovës, të cilët janë zotuar se heqin dorë nga përpjekjet për t'i shfuqizuar Dhomat e Specializuara.

Vendet e Quintit kanë vlerësuar se vetëm duke mbështetur sundimin e ligjit dhe duke siguruar drejtësi për të gjitha viktimat, Kosova mund ta afirmojë pjekurinë e saj si shtet dhe gatishmërinë për t'u integruar tërësisht në Evropë dhe komunitetin ndërkombëtar. Sipas tyre, me mbështetjen e Dhomave të Specializuara

mundësohet mbështetje e vazhdueshme nga miqtë dhe aleatët më të ngushtë të Kosovës.

"Mirëpresim deklaratat e fundit të udhëheqësve politikë kosovarë, të cilët zotohen se heqin dorë nga përpjekjet për t'i shfuqizuar Dhomat e Specializuara. Presim nga udhëheqësit e Kosovës ta mbajnë fjalën e tyre, kurse nga institucionet e Kosovës presim ta nderojnë këtë gatishmëri. Vetëm duke mbështetur sundimin e ligjit dhe duke siguruar drejtësi për të gjitha viktimat, Kosova mund ta afirmojë pjekurinë e saj si shtet dhe gatishmërinë për t'u integruar tërësisht në Evropë dhe komunitetin ndërkombëtar. Me mbështetjen e Dhomave të Specializuara mundësohet mbështetje e vazhdueshme nga miqtë dhe aleatët më të ngushtë të Dhomave të Specializuara Kosovës tani kur festojmë

shumë të arritura në dekadë, që nga pavarësia", është thënë në deklaratën e përbashkët të Ambasadës së Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shtetet e Quintit patën reaguar ashpër pas një nisme të 43 deputetëve për shfuqizimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Gjykatën Speciale për krime lufte), e cila nuk ishte kundërshtuar as nga liderët më të lartë të shtetit të Kosovës.

Tërheqja e liderëve të Kosovës nga nisma kundër Gjykatës Speciale pasoi reagimet ndërkombëtare dhe paralamërimet për pasojë të ashpra ndaj të gjithë atyre që përpiqen ta shfuqizojnë këtë gjykatë, si një prej obligimeve ndërkombëtare që ka marrë shteti i Kosovës.



shqiptarët që kanë luftuar për liri dhe jo për serbët që kanë bërë krime në Kosovë. Kryerësit e krimeve në Kosovë enden lirshëm në Serbi, madje edhe në Kosovë. Do t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë tona duke mos përjashtuar asnjë formë të veprimt. Në kohën e zgjedhjeve do t'u bëjmë thirrje të gjithë anëtarësisë të mos dalë në votime dhe të mos i përkrahë ata që nuk po punojnë dhe nuk i mbrojnë interesat shtetërore dhe kombëtare, pra

Mbahet konferenca ndërkombëtare "Festimi i dhjetëvjetorit të pavarësisë: arritjet dhe aspiratat"

Kosova ngecën me njohje

Ndihmëspresidenti i Këshillit për Tolerancë dhe Paqe, ambasadori Nabil Ayadka, duke folur për sfidat e ndërtimit të shtetit të Kosovës, ka theksuar se shteti në zhvillim është duke u përballur me sfida dhe barriera për sigurimin e njohjeve dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 5 JANAR - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës ka organizuar të enjten një konferencë ndërkombëtare me temë "Festimi i dhjetëvjetorit të pavarësisë: arritjet dhe aspiratat", në të cilën kanë marrë pjesë personalitete të shquara politike e akademike nga vendi dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Në konferencë është theksuar progresi i arritur gjatë dhjetë vjetëve të ndërtimit të shtetit të Kosovës si dhe janë renditur aspiratat për integrimin euroatlantike që shteti i Kosovës synon.

Në hapje të konferencës, drejtori i përgjithshëm i Akademisë Diplomatike, ambasador Beqir Ismaili, ka vlerësuar se përgjatë 10 vjetëve shteti i Kosovës ka pasur mjaft të arritura. "Sot, 10 vjet pas pavarësisë, Kosova ka arritur të krijojë kushte të qëndrueshme që lidhen ngushtë me ngritjen e kapaciteteve, me ndërtimin e strategjive në arenën ndërkombëtare, përgatitjen e diplomatëve të rinj, të

cilët promovojnë, përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e Kosovës në vendet aleate, si dhe zgjerimin e lidhjeve të reja bashkëpunuese në arenën ndërkombëtare", ka thënë Ismaili. Ai ka folur edhe për rolin e Akademisë Diplomatike për përgatitjen e diplomatëve të rinj.

Ndërsa ndihmëspresidenti i Këshillit për Tolerancë dhe Paqe, ambasadori Nabil Ayadka, ka folur për sfidat e ndërtimit të shtetit të Kosovës, me theks të veçantë sfidat në njohje të reja, megjithëse, siç ka thënë ai, Qeveria po punon fuqishëm për njohjet. "Shteti në zhvillim është duke u përballur me sfida dhe barriera për sigurimin e njohjeve dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare", ka thënë Ayad, ndërkohë ka folur për kontributin e tij për trajnimin e diplomatëve të rinj.

Në diskutimet për "Njohjen diplomatike të Kosovës, diplomacinë e mbrojtjes, ndërtimin e kombit dhe raportet civile-ushtarake" kanë marrë pjesë përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, duke folur për pavarësinë e vendit ka



thënë se me gjithë mbështetjen ndërkombëtare, rruga drejt pavarësisë nuk ka qenë e thjeshtë. Sipas saj, Kosova ka njohur dhimbjen e konfliktit dhe dëshpërimin e betejës. Megjithatë, siç tha ajo, kemi qenë në gjendje të krijojmë një shtet që përpjetë të japë të drejta të barabarta për të gjithë, pavarësisht nga raca, feja dhe përkatësia etnike. "Misioni ynë më i madh është të ndërtojmë një paqe të vërtetë dhe të qëndrueshme për njerëzimin, duke promovuar një kulturë tolerancë midis popujve dhe midis shteteve. Ne ftojme sa më shumë njerëz që të jetë e mundur për t'u bashkuar me ne në këtë vizion", ka thënë zëvendësministria e Jashtme, Vuniqi.

Ndërsa zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Abduselami Shkodra, ka folur

për sukseset në konsolidimin ndërkombëtar. "Kosova në vetëm dhjetë vjet pavarësi ka arritur të bëhet shtet i krahasueshëm me vendet e rajonit. Në të gjitha raportet ndërkombëtare Kosova ka të arritura të krahasueshme me vendet e rajonit", ka thënë ai.

Ndërkaq zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, ka theksuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunimin me NATO-n. "Kosova si shtet e ka të vendosur rrugën e vet. Ne nuk jemi shtet neutral në aspektin ushtarak dhe të politikës së jashtme. Duam të anëtarësohemi në NATO dhe NATO të qëndrojë në Kosovë", ka thënë ai, ndërsa ka shtuar se Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka bërë hapat e parë për themelimin e rrjetit të diplomacisë në fushën e mbrojtjes.

Myszka Guzkowska nga Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar ka folur për diplomacinë e mbrojtjes dhe raportet civile-ushtarake. Ajo ka përmendur edhe bashkëpunimin e Armatës së Mbretërisë së Bashkuar me Forcat e Sigurisë së Kosovës. "Armata ka rol pozitiv në mbështetjen e shoqërisë", ka thënë Guzkowska.

Nga ana tjetër, Roger Mc Nally nga Link Campus University në Romë ka folur për historinë dhe filozofinë e ndërtimit të shteteve dhe të aleancave në të kaluarën dhe sfidat e shteteve në ditët e sotme. Kurse Antonio Acuna nga Ministria e Mjedisit e Mbretërisë së Bashkuar ka folur për shtetndërtimin në aspektin e zhvillimit digjital e teknologjik, si investim mjaft i mirë për ndërtimin e identitetit të një shteti.

IKShP-ja rekomandon që nxënësit me simptoma të gripit të qëndrojnë në shtëpi

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) ka njoftuar se nga 1 tetori i vitit 2017 deri më 2 shkurt të këtij viti janë raportuar gjithsej 31 383 raste me grip. IKShP-ja ka rekomanduar që nxënësit me simptoma të gripit t'i shmangen kontaktit me nxënës të shëndoshë dhe të qëndrojnë në shtëpi

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) ka bërë me dije të enjten se ka intensitet të shtuar të rasteve të gripit sezonal në gjithë territorin e Kosovës. "Gjatë javës së pestë të vitit 2018 në Kosovë janë raportuar 6 451 raste të gripit, që paraqet rritje prej 55.5 përqindësh krahasuar me javën e kaluar, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të

kaluar ka rritje të numrit të përgjithshëm të rasteve. Nga 1 tetori i vitit 2017 deri më 2 shkurt 2018 në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë raportuar gjithsej 31 383 raste të dyshimta në grip (ILI)", është thënë në njoftimin e IKShP-së. Sipas këtij institucioni, në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Gripit deri më 7 shkurt 2018 janë testuar gjithsej 322 mostra për tipizim dhe subtipizim në grip. Prej tyre 165 ose 51 përqind kanë rezultuar pozitive në influ-



encë, prej të cilave 66 mostra janë pozitive në influencën A (1 rast A (H1) dhe 99 në influencën B (48 raste janë B subtipi Yamagata).

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka kërkuar nga ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë që t'i njoftojë të gjitha institucionet parashkol-

lore, fillore dhe të mesme (publike dhe private), se të gjithë fëmijët dhe nxënësit me shenja dhe simptoma të gripit (temperaturë e lartë, lodhje, rrjedhje të hundëve, dhimbje fyti, kollë, barkqitje dhe vjellje, dhimbje koke, barku e muskujsh) t'i shmangen kontaktit me nxënës të shëndoshë dhe të qëndrojnë në shtëpi, duke iu përmbytur rekomandimeve të mjekut.

IKShP-ja u ka rekomanduar qytetarëve të kenë kujdes dhe të mos dalin gjatë në ambient të ftohtë, të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura me dendësi të madhe të njerëzve dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina. Sipas IKShP-së, të gjithë personat që ndihen të sëmurë duhet të paraqiten sa më herët te mjeku familjar për t'i parandaluar komplikimet.

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë plenare

Urgjentisht kërkohet të intervenohet në Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'

Në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës, deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka folur për gjendjen jo të mirë të Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ai ka kërkuar urgjentisht të intervenohet në shtëpitë muze të familjes Jashari. Ndërsa deputeti i Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, ka thënë se fajin për gjendjen e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" e kanë PDK-ja dhe LDK-ja

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Në Kuvendin e Kosovës të enjten është mbajtur seanca plenare, në të cilën ishte paraparë të mbahej interpelanca për ngritjen e pagave për anëtarët e kabinetit qeveritar dhe debati për raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë, por një gjë e tillë nuk ndodhi në mungesë të kryeministrit Ramush Haradinajt, i cili po qëndron për vizitë në ShBA. Këto dy pika janë shtyrë për një seancë tjetër, në të cilën pritet të jetë i pranishëm edhe kryeministri Haradinaj.

Në seancën e së enjtes deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë kërkuar që urgjentisht të intervenohet në shtëpitë muze në Kompleksin Memorial "Adem Jashari".

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka folur për gjendjen jo të mirë të Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ai ka kërkuar urgjentisht që të intervenohet në shtëpitë muze të familjes Jashari. Haxhiu ka thënë se në legjislaturën e kaluar është miratuar një amendament, i cili, sipas tij, mundësonte investime në Kompleksin Memorialin "Adem Jashari". "Amendamenti i miratuar në Kuvend do të duhej t'i hapte rrugë konservimit dhe restaurimit të shtëpive muze në lagjen Jashari në Prekaz, por Agjencia për Mbrojtjen e Komplekseve Memoriale nuk bëri punën e duhur. Pavarësisht prej ndarjes së

mjeteve financiare, kodit buxhetor për restaurimin dhe konservimin e shtëpive muze, puna nuk ka filluar as atëherë, as sot e, për më keq, mjetet e planifikuara nuk u shpenzuan, ato u ridestinuuan dhe disa prej mjeteve shkuan edhe në suficit", ka thënë Haxhiu në kohën e deklaramëve jashtë rendit të ditës në Kuvendin e Kosovës.

Edhe deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka folur rreth Kompleksit Memorial "Adem Jashari", sipas të cilit, nëse nuk merren masa atëherë kullat e Jasharëve do të shemben. Ndërsa deputeti i Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, ka thënë se fajin për gjendjen e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" e kanë PDK-ja dhe LDK-ja.

Seanca ka vazhduar me fjalimin e kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për aktivistët e dënuar të kësaj lëvizjeje. Kurti ka thënë se rasti i sulmit ndaj aktivistëve të Vetëvendosjes për sulm ndaj ndërtesës së Kuvendit të Kosovës ishte i montuar. Ai gjatë debatit parlamentar për këtë rast, të kërkuar nga Vetëvendosja, është shprehur se ata janë arrestuar dhe dënuar nga urdhri politik por, sipas tij, kjo kishte të bënte me hakmarrje nga Policia e Kosovës ndaj protestave të këtij subjekti.

"Arrestimi i aktivistëve ishte hakmarrja e dytë ndaj Vetëvendosjes", ka thënë Kurti. Kurse deputetja e Lëvizjes



Vetëvendosje!, Albulena Haxhiu, ka kritikuar deputetët e Kuvendit të Kosovës për mosprani në seancë në kohën kur po diskutohet për arrestimin e aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosjeje. Deputetja Haxhiu pati kritika për deputetët e LDK-së për të cilët tha se e lëshuan seancën për arsye se ish-kryeministri Mustafa është përgjegjës për arrestimin e aktivistëve të IV-së. "LDK-ja e lëshoi sallën për shkak të përgjegjësisë që e ka Isa Mustafa për arrestimin e aktivistëve të Vetëvendosjes", ka deklaruar Haxhiu. Sipas saj, Taçi, Veseli dhe Mustafa janë përgjegjës për gjithë këtë proces që, siç e ka quajtur ajo, është kryekëput politik. Haxhiu gjatë fjalimit të saj për këtë proces e ka kritikuar edhe gjyqtarin e rastit, Beqir Kalludra. Ndërkaq deputeti i Lëvizjes Vetëvendosjeje, Rexhep Selimi, nga foltoja e Kuvendit ka ngritur çështjen e skandaleve në Inspektoratin e Policinë e Kosovës (IPK). Ai ka thënë se ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, duhet të marrë masa ndaj drejtorit të përgjithshëm të policisë duke e ngarkuar atë me përgjegjësinë kryesore për gjendjen në Policinë e Kosovës. Selimi ka thënë se IPK-ja dhe Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike janë diskredituar deri

në themel për shkak të krerëve të instaluar në këto institucione. "Tashmë është gjithçka e qartë, në një vend ku kryeprokurori i Shtetit kapet si falsifikator i provimit të jurisprudencës, ku drejtori i Departamentit të Hetimeve të Krimeve Ekonomike rrah drejtorin e institucionit publik (Agron Mustafën) në mes të Prishtinës dhe nuk suspendohet. Në një vend ku shohim në medie qindra mijëra euro duke u numëruar në llogari të oficerëve të lartë të Policisë së Kosovës dhe nuk suspendohet protagonistin, në një vend ku dëgjojmë në medie skandale sikur ai i kryshefit të IPK-së duke i kërcënuar vartësit e tij për të kryer punësime të paligjshme, e në fund të gjithë këta rezultojnë të jenë në bashkëveprim dhe në mbrojtje të njëri-tjetrit, atëherë s'kemi se si ta quajmë këtë ndryshe përveçse një rrjet i sofistikuar i kimit të organizuar që ka kapur mekanizmat vitalë të shtetit. Kështu duket shteti i kapur. Kjo nuk është një fantazi", ka thënë Selimi. Deputeti Selimi ka kërkuar të shkarkohet kushdo që është përfshirë në vepra të tilla në mënyrë që Prokurorisë t'i hapet rruga për hetim.


Ndaj këtyre çështjeve të ngritura nga deputeti Selimi është përgjigjur ministri i MPB-së, Flamur Sefaj, e cili ka thënë se është duke punuar në bazë të përgjegjësisë që ia jep ligji. Edhe Policia e Kosovës (PK) ka reaguar ndaj akuzave të deputetit të Vetëvendosjes, Rexhep Selimi, lidhur me skandalet e fundit në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe për akuzat ndaj kreut të policisë. "Sa i përket dyshimeve dhe hipotezave të ngritura nga deputeti Selimi se, kinse, drejtori i Policisë së Kosovës po i mbron vartësit që kanë kryer vepra penale, ju sigurojmë se këto deklarime janë të pavërteta dhe tendencioze", është thënë në reagimin e PK-së.

Ministri Sefaj: Kosovës ia shpëtuam 600 mijë euro

Ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, në seancën e së enjtes ka thënë se ka arritur ta mbyllë çështjen e problemit të pasaportave. Sipas tij, ai ka qenë i autorizuar nga kryeministri Ramush Haradinaj që ta zgjidhë çështjen e problemit të pasaportave. "Unë kam qenë i autorizuar që ta mbyll çështjen e pasaportave që ka pasur një kosto shumë të lartë, sepse e kemi humbur kauzën në arbitrazh. Na është dashur t'i paguajmë 6 milionë e 500 mijë euro, derisa vetëm 5 milionë e 900 mijë euro janë paguar. Kemi arritur t'i shpëtojmë 600 mijë euro", ka thënë ministri Sefaj.

"Rasti Dehari", Kurteshi e Tahiri debatojnë në Kuvend

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosjeje, Sami Kurteshi, ka kërkuar nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, të japë logari për vendimet që janë arritur për hetimin e rastit të vdekjes së aktivistit Astrit Dehari. Duke iu referuar një takimi që kryeministri Haradinaj kishte realizuar me prindërit e të ndjerit Astrit Dehari, Kurteshi ka pohuar se nuk është zbatuar kërkesa e plotë e familjes Dehari për hetim. "Familja kërkon një hetim të plotë të pavarur nga një institut me renome botërore deri në zvarrosjen e trupit të të ndjerit", ka thënë Kurteshi. Ndërsa me të përfunduar deputeti Kurteshi, ministri Abelard Tahiri ka konfirmuar se tashmë janë ndarë mjetet për hetimin e rastit në mënyrën siç dhe kanë kërkuar prindërit e aktivistit të Vetëvendosjes.



OEK-u shqetësohet me mosdefinimin e qartë të perspektivës evropiane për Kosovën

PRISHTINË, 8 SHKURT (ER) - Komuniteti i biznesit, përfaqësuar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), ka shprehur zhgënjimin e thellë me dokumentin e fundit të publikuar nga Komisioni Evropian, përmes të cilit definohet strategjia e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, përkatësisht raportet e ardhshme në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. "Përderisa ka një përcaktim të qartë të relacioneve dhe anëtarësimit të mundshëm për pesë vende të Ballkanit Perëndimor, në rastin e Kosovës, perspektiva evropiane mbetet në nivel të status quos pothuajse të njëjtë me nivelin e vitit 2004, kur në Samitin e Selanikut është përcaktuar ofrimi i 'perspektivës evropiane' për vendet e Ballkanit Perëndimor. Që nga Samiti i Selanikut vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor kanë avancuar dukshëm në rrugën e anëtarësimit në BE, ndërsa me Kosovën ka vetëm vazhdim të 'eksperimenteve frazeologjike', nga vokabulari i burokratëve evropianë", është thënë në reag-

imin e OEK-ut.

Oda Ekonomike e Kosovës ka vlerësuar se nga aspekti i ndikimeve të mundshme në ekonominë e vendit, për të cilin angazhohet edhe OEK-u si institucion, strategjia e zgjerimit e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, si një dokument që do të ndikojë edhe në orientimin e investimeve të huaja në rajon, do të ndikojë negativisht në tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë. "Me një perspektivë evropiane të paqartë askush nga investitorët e huaj nuk do të gjejë arsye të investojë në Kosovë, kur në të njëjtin rajon gjeografik ka vende të cilat në vitin 2025 presin të bëhen anëtare të BE-së. Për më shumë, për herë të parë një dokument strategjik dhe zyrtar i BE-së i referohet kapjes së strukturave të rëndësishme shtetërore, nga politikanë dhe grupe të interesit, në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky mund të duket vetëm një formulim më shumë por, në fakt, kjo do të jetë sfida kryesore për zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian të këtyre



vendeve, veçanërisht Kosovën, me probleme të theksuara të sundimit të ligjit dhe dukurive negative", thuhet në reagimin e OEK-ut. OEK-u u ka bërë thirrje institucioneve të vendit të bëjnë një

kthesë për të marrë kah pozitive për adresimin e problemeve dhe prioriteteve të theksuara në strategjinë për zgjerim të BE-së. Po ashtu, OEK-u ka potencuar të merren parasysh edhe propozimet e këtij institucioni

dhe kërkesat shumë specifike të sektorit privat për zhvillim ekonomik, luftim të ekonomisë joformale, dekriminalizim të strukturave të rendit dhe ligjit dhe, mbi të gjitha, reformave substanciale në edukim.

Ministri Hasani premton 3.5 milionë euro investime në Malishevë

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka thënë se duke u bazuar në kërkesën e Komunës së Malishevës, ministria që drejton do ta mbështesë ndërtimin e një zone ekonomike dhe një inkubatori të biznesit në Malishevë, të cilat kapin vlerën rreth 3.5 milionë euro

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

MALISHEVË, 8 SHKURT - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani dhe zëvendësministri i kësaj ministrie, Faton Thaçi, kanë qëndruar të enjten në Malishevë, ku janë takuar me kryetarin e kësaj komune, Ragip Begaj.

Ministri Hasani ka thënë se duke u bazuar në kërkesën e Komunës së Malishevës, ministria që drejton do ta mbështesë ndërtimin e një zone ekonomike dhe një inkubatori të biznesit në Malishevë, të cilat kapin vlerën rreth 3.5 milionë euro. "Malisheva nga sot mund të llogaritet në dy projekte të mëdha kapitale që do të mbështetën nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ku njëra është zona ekonomike, e cila do të kushtojë mbi tre milionë

euro, e tjetra është inkubatori i bizneseve që do të kushtojë rreth 500 mijë euro. Pra, Malisheva mund të llogaritet në 3.5 milionë euro investime nga MTI-ja", ka thënë Hasani. Ai ka bërë me dije se MTI-ja i ka dhënë prioritet ndërtimit të zonave ekonomike, pasi përmes kësaj do të ofrohen edhe investitorët e jashtëm dhe të brendshëm.

Ndërsa kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar ministrin Hasani për këtë përkrahje. "Ne si komunë kemi nevojë për ndërtimin e një zone ekonomike dhe një inkubatori për biznese. Kjo ka qenë kërkesë e jona tani e disa vite, por vetëm këtë vit ka arritur ta gjejë përkrahjen e ministrit dhe, me këtë rast, e falënderoj ministrin Hasani për përkrahjen e dhënë për ndërtimin e kësaj zone ekonomike si dhe zotohem që



komuna do t'i kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për fillim e realizimit të këtij projekti me rëndësi për Komunën e Malishevës", ka thënë Begaj. Pas këtij takimi ministri Hasani, i shoqëruar edhe nga

nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, kanë vizituar edhe ndërmarrjen "Delfina" në Kijevë, e cila merret me prodhimin e mobilieve. Po ashtu, ministri Hasani është njoftuar edhe me punën dhe

problemet që hasin prodhuesit vendorë qoftë për sigurimin e lëndës së parë, por edhe me probleme të natyrave të ndryshme gjatë punës së përditshme dhe plasimit në treg të prodhimeve.

MPMS-ja certifikon 164 punëkërkuës të rinj



Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka theksuar se në periudhën njëvjeçare përmes programeve të ndërmarrësisë kanë përfituar mbi 160 punëkërkuës. Ai ka bërë me dije se do të krijohen edhe 50 ndërmarrje të reja dhe do të hapen mbi 100 vende të reja të punës

**EPOKA
ERE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 8 SHKURT - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me mbështetje të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), ka bërë certifikimin e 164 punëkërkuësve të rinj të cilët kanë ndjekur trajnimin për

programet e ndërmarrësisë dhe vetëpunësimin. Në ceremoninë e certifikimit të tri programeve të vetëpunësimin të financuara nga MPMS dhe GIZ, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se sot po kurorëzohet një angazhim i përbashkët drejt hapjes së perspektivës për të rinjtë në Kosovë. "Në periudhën gati

njëvjeçare përmes programeve të ndërmarrësisë kanë përfituar mbi 160 punëkërkuës. Po ashtu, do të krijohen 50 ndërmarrje të reja dhe do të hapen mbi 100 vende të reja të punës. Kjo ka ndikim të madh në mirëqenien e mbi 300 familjeve në Kosovë", ka deklaruar ministri Reçica.

Ministri ka falënderuar

Qeverinë Gjermane, në veçanti GIZ-in, për bashkëpunimin në implementimin e këtyre projekteve të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e mundësive për të rinjtë dhe në zbutjen e papunësisë në Kosovë, gjë që përbën edhe një nga objektivat kryesore të MPMS-së.

Drejtori i GIZ-it për Kosovë, James Macbeth, ka thënë se angazhimi i përbashkët i tyre me MPMS-në është një mbështetje e madhe për të rinjtë si dhe mundësi për gjenerimin e vendeve të reja të punës. Kurse

sekretarja e parë e Ambasadës Gjermane në Kosovë, Anja Becky, ka falënderuar ministrin Reçica për bashkëpunimin sa i përket mbështetjes së të rinjve, veçanërisht në fushën e ndërmarrësisë që, sipas saj, shënon një nga aktivitetet kryesore të Qeverisë gjermane. Gjatë ceremonisë, ministri Reçica bëri shpërndarjen e granteve për përfituesit e tri programeve kryesore, Akademisë së Ndërmarrësisë së Gjelbër, Akademisë së Ndërmarrësisë në Kosovë dhe për ndërmarrësit e rinj.

Punëtorët e KEK-ut kërkojnë rritjen e pagave

PRISHTINË, 8 SHKURT - Sindikata e re e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ka mbajtur të enjten një protestë me kërkesë ngritjen e pagave për punëtorët e KEK-ut në mënyrë lineare nga 100 euro. Pjesëmarrës në protestë mbanin në duar pankarta me mbishkrime si "Duam ngritjen e pagave, edhe ne e duam jetën", "Qeveri këndellu, Kosova nuk bën pa dritë" etj.

Kryetari i kësaj sindikate, Rafet Osmani, ka thënë se askush nuk mund t'i ndalë nga kërkesat e tyre dhe se ato duhet të realizohen. "Po e kërkojmë dinjitetin tonë dhe pagat duhet të ngrihen prej poshtë dhe lart. Kërkesat tona janë minimale dhe duhet të realizohen. Por, realizimi ka ngelur në fjalë, por kërkojmë të realizohet kjo kërkesë", është shprehur Osmani.



Bahtiri u jep përkrahje drejtuesve të Spitalit të Mitrovicës

MITROVICË, 8 SHKURT - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të enjten në takim ushtruesin e detyrës së Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, Hamëz Berisha dhe bashkëpunëtorët e tij. Pjesë e këtij takimi ishte edhe drejtorësja e Drejtorisë së Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, drejtori i Urbanizmit, Sami Zeka dhe zyrtarë të tjerë komunalë.

Ndërtimi i objektit të Ambulantes Specialistike dhe ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në një lokacion ka qenë temë kryesore e diskutimit të kryetarit Bahtiri

dhe drejtorit Berisha. Gjatë bashkëbisedimit, ushtruesi i drejtorit të spitalit, Hamëz Berisha, ka thënë se ndërtimi i këtyre dy objekteve në një lokacion të përbashkët është shumë i rëndësishëm.

Berisha ka falënderuar kryetarin Bahtiri, i cili ka treguar gjithmonë gatishmëri për të bashkëpunuar me spitalin rajonal të Mitrovicës për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Ndërsa kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se kjo komunë gjithmonë ka qenë e interesuar që spitali të ofrojë shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës.



Klina formon këshillin organizativ për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë

KLINË, 8 SHKURT - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka formuar këshillin organizativ për shënimin e 10-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së

Kosovës. Ky këshill përbëhet nga kryetari i komunës, kryesuesi i Kuvendit Komunal, nënkryetari Besim Hoti, drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Skënder Merturi dhe Arben Limanaj, drejtor i Arsimit. Në këtë këshill nga një përfaqësues do ta kenë edhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe nga një

përfaqësues subjektet politike që përfaqësohen në Kuvendin Komunal të Klinës.

Në prag të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, qyteti i

Klinës është stolisur me flamurin kombëtar e shtetëror, derisa janë planifikuar të mbahen aktivitete kulturore dhe sportive deri më 17 shkurt.

Nisin investimet në qytetin e Rahovecit

RAHOVEC, 8 SHKURT - Kanë nisur punimet në lagjen e Epërme në qytetin e Rahovecit për rregullimin e një trafo të energjisë elektrike si dhe për vendosjen e gypave të betonit në kanal in e hapur. "Po ashtu, kanë vazhduar punimet edhe për evitimin e problemeve me kanalizim fekal që përshkon aksin rrugor nga qyteti i Rahovecit me fshatin Drenoc. Tani e tutje nuk do të ketë më probleme me kanalizim për banorët të cilët kanë pasur probleme deri më tani", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Rahovecit.



Në fshatin Krushë e Madhe përrurohet objekti i ri i zyrës së gjendjes civile

Rahovec, 8 shkurt - Në fshatin Krushë e Madhe të Komunës së Rahovecit është përruruar objekti i ri i zyrës së gjendjes civile. Me ndërtimin e këtij objekti punëtorëve të cilët punojnë aty dhe qytetarët të cilët shkojnë për t'u pajisur me dokumente nga tani e tutje do t'u ofrohen kushte shumë më të mira. Objekti i ri i zyrës së gjendjes civile në këtë fshat ka hapësirë prej 150 metrash katrorë dhe është investim nga buxheti komunal. Ky investim kap vlerën prej 42 mijë e 866 eurosh.



'MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN'

Adem Demaçi, ndër personalitetet më me fat në historinë më të re të Kosovës



Selatin **NOVOSELA**

Adem Demaçi, duke qenë i lindur në kohën e Aleksandër Karagjorgjeviqit, në vitin 1936; duke filluar veprimtarinë atdhetare-politike në kohën e Aleksandër Rankoviqit, në vitin 1958; duke arritur kulmin e veprimtarisë në kohën e Josip Broz Titos, si kryetar i Organizatës Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, në vitin 1964; dhe duke përjetuar çlirimin e Kosovës, si përfaqësues i përgjithshëm politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kohën e Sllobodan Milloseviqit, në vitin 1999, është ndër personalitetet më me fat në historinë më të re të Kosovës

Në vend të hyrjes

Me Adem Demaçin jam takuar për herë të parë në vjeshtën e vitit 1963 në një orë letrare në Shkollën Normale të Prishtinës. Atë e prezantoi Zeqir Gërvalla, miku i Adem Demaçit dhe kryetar i grupit letrar "Migjeni". Pra, po bëhen më shumë se gjysmë shekulli që, në vazhdimësi isha dhe jam pranë Bacës Adem. Kështu, në vitin 1964, isha anëtar i organizatës atdhetare të formuar dhe të udhëhequr nga ai "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve". Prej vitit 1969 deri në vitin 1973, isha së bashku, në burgun e Pozharevcit, ku Baca po e vuante dënimin e dytë 15-vjeçar. Pastaj, në vitin 1975, jam dënuar në gjykimin e tretë të Bacës së bashku edhe me dëshmorët Rexhep Mala, Isa Kastrati dhe 15 veprimtarë të tjerë. Edhe gjatë viteve të '90-ta të shekullit që lamë pas, gjatë aktiviteteve në subjektet politike të asaj kohe, kishim angazhime të përbashkëta. Ndërsa, pas çlirimit të Kosovës, në vitin 1999, me Adem Demaçin jam përditë bashkë! Çka të thotë kjo? Kjo, thënë shkurtazi, nënkupton se nga ky vit grumbulloj, sistemoj, analizoj çdo libër, revistë, gazetë, dokument, faksimil, fotografi dhe poezi që bëjnë fjalë për jetën dhe veprën e

Adem Demaçit. Kështu, gjatë këtyre viteve, në arkivin tim kam sistemuar mbi 10.000 faqe me dokumente gjyqësore nga tri gjykimet e Bacës (1958, 1964, 1975), programet politike, dorëshkrimet, intervistat, fjalimet, analizat, opinionet, polemikat dhe reagimet e tij. Nga ky material, deri tashti, kam botuar librat kushtuar jetës dhe veprës së Bacës: "Adem Demaçi në gjykimin e parë -1958", "Adem Demaçi në gjykimin e dytë - 1964", "Adem Demaçi në gjykimin e tretë - 1975", "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve - sipas dokumenteve arkivore", "Demaçi - Metaforë lirike" (libër me mendime dhe vlerësime të rreth 100 personaliteteve të ndryshme për Adem Demaçin), "Demaçi - Aromë atdheu" (libër me 80 poezi të poetëve të ndryshëm kushtuar Adem Demaçit) dhe "Viti i Adem Demaçit" (botuar me rastin e shënimit të 80-vjetorit të lindjes së Demaçit).

Duke e njohur nga afër rrugën e jashtëzakonshme jetësore të Bacës, nga njëra anë, duke e pasur parasysh tërë bagazhin e madh të shkrimeve të Bacës, nga ana e dytë dhe, nga ana e tretë, duke e pasur parasysh krejt atë që është thënë për Bacën, kam vendosur që, me këtë shkrim, të prezantoj një pjesë të mendimeve dhe vlerësimeve të 200 personaliteteve për Bacën.

Për Adem Demaçin kanë shprehur mendimet e tyre presidentë, kryeministra, kryeparlamentarë, kryetarë komunash, historianë, diplomatë, ministra, rektorë universitetesh, ushtarakë, akademikë, shkrimtarë, poetë, kritikë letrarë, analistë, publicistë, bashkëveprimtarë, bashkëvuajtës etj. Për Adem Demaçin nuk kanë folur vetëm personalitetet e shquara shqiptare nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe diaspora shqiptare por edhe amerikanë, anglezë, suedezë, francezë, belgë, gjermanë, bullgarë, serbë, kroatë, slovenë, boshnjakë etj. Autorë të panumërt që kanë shkruar për Adem Demaçin kanë zgjedhur fjalët më të bukura, krahasimet më të fuqishme, epitetet më domethënëse dhe metaforat monumentale për të.

Për Adem Demaçin thuhet se është: simbol i bashkimit, simbol i lirisë, simbol i qëndrësës, simbol i guximit, simbol i vetëflijimit, simbol i sakrificës,

simbol i durimit, simbol i fitores, simbol i besimit, simbol i ngadhënjimit, simbol i shpresës, simbol i krenarisë, simbol i shpëtimit etj. Për Adem Demaçin, po ashtu, thuhet se është: legjendë e gjallë, hero i gjallë, aromë atdheu, metaforë lirike, strateg i rrallë, vizionar largpamës, projektues liric, frymëzues brezash, krenari kombëtare, nderi i kombit, bashkues brezash, humanist i madh, i panënshtuar i durueshëm, figurë unike kombëtare, martir i kombit, histori e gjallë, ideator i Lëvizjes Kombëtare, udhërrëfyes liric, artikules i ëndrrave të shqiptarëve, personalitet i pazvëndësueshëm, sfidues i madh, korifë, ylli polar, idol i brezave, zë i ndërgjegjes kombëtare, flamurtar i Lëvizjes Kombëtare, inspirues i ideve çlirimtare, emër që flet vet, vulkan i pashuar, feniksi shqiptar, përmendore e gjallë, burrë me palcë Shqipërie, figurë e spikatur, burrë legjendar, libër i hapur, luftëtar i pathyeshëm, i burgosuri numër një në Jugosllavi, zë i fuqishëm i UÇK-së, pajtues i rrymave politike, udhëheqës shpirtëror, flamurtar në beteja, emblemë kombëtare, titan i pathyeshëm, ikonë e nacionalizmit, zë i guximit, zë i shpresës, zë i forcës, zë i sakrificës etj.

Duke e krahasuar Adem Demaçin me personalitetet e rralla historike, autorë të ndryshëm atë e quajnë: Anteu shqiptar, Zeusi shqiptar, Krishti shqiptar, Prometheu shqiptar, Mesia shqiptar, Drjafusi shqiptar, Mendela shqiptar, Marathonamaku shqiptar etj. Kritikë dhe studiues të letërsisë

thanë për Adem Demaçin se ai është: autor i spikatur, letrar i harmonisë shqiptare dhe njerëzore, krijues kulminant në letërsi, rast unik në letërsinë shqipe, model i tregimitarit modern, shkrimtar i terrorizuar, shkrimtar i dalluar i zhanrit romanesh, mjeshtër i rrallë i artit letrar, fenomen i rrallë në letërsi, autor i mesazheve të drejtpërdrejta etj. Ndonëse ky libër mbanë nëntullin "Mendime të zgjedhura për Adem Demaçin", megjithatë, këtu do prezantohen edhe disa mendime, qëndrime, vlerësime dhe analiza të Adem Demaçit për ngjarje dhe procese të veçanta që janë zhvilluar në Kosovë dhe rreth saj. Duke i prezantuar këto vlerësime të Adem Demaçit, besoj se portreti i tij të prezantohet më i plotë.

Përkritazi me renditjen e këtyre mendime të zgjedhura për Adem Demaçin, gjatë tërë kohës së grumbullimit të tyre, që ka zgjatur me vite të tëra, kam pasur dilemat se si të radhiten ato? Herë-herë mendoja që ato të radhiten sipas rëndësisë së personaliteteve që i kanë shprehur ato mendime; herë-herë mendoja që radhita të bëhet sipas kohës kur janë thënë ato mendime; herë-herë mendoja që të radhiten sipas tematikës që përfshihet në ato mendime (siç janë tematika politike, kombëtare, letrare, publicistike, humanitare, filozofike, etike etj.). Megjithatë, në fund, vendosa që mendimet të prezantohen sipas abc-së. Fillimisht e kisha konceptuar libër me shkrim si libër ku do të prezantoheshin vetëm

mendimet e të tjerëve për Adem Demaçin. I bindur se të gjitha këto mendime dhe vlerësime për Demaçin nuk do të mund ta paraqesin në plotëni figurën unike të tij, vendosa që t'i prezantoj edhe disa mendime të Demaçit për ngjarje dhe procese politike si dhe për disa personalitete të shquara.

Në fund të librit do të prezantohen edhe shpërblimet, çmimet, dekoratat, mirënjohjet dhe falënderimet e ndara për Adem Demaçin nga institucione të ndryshme shtetërore, qeveritare, shkencore, kulturore, të shoqatave joqeveritare, komunave të ndryshme etj. Të gjitha këto do të prezantohen kronologjikisht e jo sipas rëndësisë dhe peshës që kanë këto shpërblime për Demaçin.

Po të shprehesh me fjalorin e piktorit do të thosha se, duke i grumbulluar në një vend këto mendime të zgjedhura për Demaçin, kam synuar ta japim, të gjithë së bashku, portretin e Demaçit duke e plotësuar secili, veç e veç, nga një katror të mozaikut të portretit të tij. Ndërsa, po të shprehesh me fjalorin e kompozitorit, do të thosha se me këto mendime kam synuar që ta këndojmë një këngë polifonike, secili me zërin e tij, një këngë të veçantë që do të mund t'i kushtojë vetëm njeriut të rrallë, atdhetarit unikat, humanistit shembullor, shkrimtarit të njohur, Heroit të Kosovës dhe Nderit të Kombit - Adem Demaçit.

Nëse kam arritur, qoftë edhe pjesërisht, që ta bëjë një punë të tillë, tepër të vogël, do të ndihesha mirë. (Vijon)



Pentagoni po sheh mundësitë për një paradë ushtarake



Pentagoni po bën plane për një demonstrim të fuqisë ushtarake në kryeqytetin amerikan. "Po punojmë mbi disa variante dhe do t'i çojmë për vendimmarrje në Shtëpinë e Bardhë", tha sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis

WASHINGTON, 8 SHKURT - Presidenti Donald Trump dëshiron zhvillimin e një parade ushtarake që të tejkalojë për nga madhështia atë të zhvilluar në Paris vitin e kaluar me rastin e "Ditës së Bastijës". Dhe Pentagoni po bën plane për një demonstrim të fuqisë ushtarake në kryeqytetin amerikan. Sekretari amerikan i Mbrojtjes njoftoi të mërkurën se po punohet për zhvillimin e mundshëm të një parade ushtarake. "Po punojmë

mbi disa variante dhe do t'i çojmë për vendimmarrje në Shtëpinë e Bardhë", tha Jim Mattis. Arsyet mbi kërkesën e papritur të presidentit variojnë. Mattis thotë se është rrjedhojë e dashurisë që Trumpi ka për trupat ushtarake. "Respekti i presidentit, simpatia që ka ai për ushtrinë, mendoj se është arsyeja e kërkesës së tij", tha ai. Por të tjerë e shohin si qasje narcisiste. "Kjo nuk ka të bëjë me trupat. Kjo është thjesht për ta

kënaqur egon e komandantit të Forcave të Armatosura", thotë i gjeneralmajori Paul Eaton, një ish-ushtarak në pension.

Presidenti Trump ka thënë shpesh se do një paradë që tejkalon për nga madhështia atë të zhvilluar në Paris në korrikun e kaluar.

Por paradat madhështore ushtarake në ShBA janë të rralla. Më e fundit u mbajt në fillimet e 1990-s për ta festuar fitoren e amerikanëve në Luftën e Gjirit.

Kritikët thonë se paradat ushtarake lidhen kryesisht me diktaturat, nga parakalimet me raketa të Koresë së Veriut, festimet dhjetërvajçare në Sheshin e Kuq në Rusi, të shfaqja që Kina dha për Trumpin gjatë vizitës së tij atje.

Sipas gjeneralit Eaton, Ushtria amerikane ka gjera më të rëndësishme për të bërë. "Me angazhimin në vazhdim në Afganistan, me tërheqjen graduale nga Iraku dhe, ndoshta, përgatitjet për Korenë e Veriut, trupat nuk kanë kohë. Pra, kjo është thjesht dhe vetëm një ide jashtëzakonisht e keqe", tha Eaton.

Pas një marrëveshjeje për një financim të plotë të ushtrisë të miratuar në Senat, gjetja e parave për një sipërmarrje të tillë do të jetë e vështirë. Por, presidenti Trump nuk njihet për tërheqje nga vendimet e tij.

LAJME SHKURT



Turqia dhe Rusia diskutojnë koordinimin ushtarak në Siri

MOSKË, 8 SHKURT - Presidenti rus Vladimir Putin dhe ai turk, Rexhep Tajip Erdogan, janë pajtuar për të rritur koordinimin në mes të ushtrive të të dy shteteve dhe shërbimeve të sigurisë në Siri, ka njoftuar Kremli.

Zyra e Putinit ka lëshuar deklaratën pasi të dy presidentët kanë biseduar të enjten në telefon. Është thënë se planet për një bashkëpunim më të ngushtë kanë qëllim përmirësimin e luftës kundër grupeve terroriste të cilat janë duke shkelur regjimin e armëpushimit në provincën Idlib, që gjendet në kufi me Turqinë.


Një pilot i Ushtrisë ruse ka vdekur pasi aeroplani luftarak Su-25 është rrëzuar më 3 shkurt, nga rebelët që kontrollojnë zonën e Idlibit.

Rusia dhe qeveria e presidentit sirian, Bashar al-Assad, të cilën Rusia e ka mbështetur me një fushatë të sulmeve ajrore e tokësore nga shtatori i vitit 2015, iu referohet si terroristë, shumicës së forcave që luftojnë kundër qeverisë.

Putini dhe Erdogani kanë diskutuar për atë që ka thënë Kremli, "rëndësinë e vazhimit të punës së përbashkët të Rusisë, Turqisë dhe Iranit" në Siri. Zëdhënësi i Kremliut, Dmitry Peskov ka thënë se kanë diskutuar një takim të mundshëm në mes të Putinit, Erdoganit dhe presidentit iranian, Hassan Rohani, mirëpo ende nuk është caktuar ndonjë datë.

Zyrtarët turq janë cituar më vonë të kenë thënë se takimi do të ndodhë në Stamboll.

Rusia dhe Turqia kanë mbështetur anë të kundërtën në luftën e Sirisë. Mirëpo së bashku me Iranin kanë sponsorizuar një seri takimesh të mbajtura kryesisht në Kazakistan, por edhe në Soçi në Rusi, me qëllim të përfundimit të konfliktit.



Tetë kandidatë garojnë për president të Rusisë

MOSKË, 8 SHKURT - Tetë kandidatë do të garojnë në zgjedhjet presidenciale në Rusi më 18 mars. Lajmi u bë i ditur nga shefja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ella Pamfilova, në ditën e fundit të procesit të regjistrimit të kandidatëve.

Në mesin e tyre është edhe presidenti aktual, Vladimir Putin.

Me vlerësime të larta dhe me kontroll në të gjitha nivelet e pushtetit, Putini pritet t'i fitojë zgjedhjet. Kandidatët e tjerë janë: Ksenia Sobchak, gazetare, Boris Titov nga Partia e Rritjes, Sergei Baburin nga Partia e Unionit Popullor, Grigory Yavlinsky nga Partia Yabloko, Vladimir Zhirinovskiy, ultranacionalist, Pavel Grudinin nga Partia Komuniste dhe Maksim Suraikin, po ashtu komunist.

Mbahet Mëngjesi i Lutjeve në Uashington

WASHINGTON, 8 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump foli të enjten në Mëngjesin e 66 të Lutjeve, një ceremoni e përvitshme ku presidentët mbledhen me udhëheqës botërorë fetarë, politikë, socialë dhe të biznesit nga e gjithë bota, për ta nderuar besimin dhe miqësinë. Presidenti Trump tha se besimi është qendror në jetën e amerikanëve. Ai foli për shpirtin e amerikanëve dhe ndihmën që i japin njëri-tjetrit në momente të vështira dhe në nevojë. "Ne shohim hirin e Zotit tek ushtarët

tanë që rrezikojnë jetën për lirinë tonë. E shohim te mësuesit që punojnë pa u lodhur për nxënësit e tyre dhe policët që sakrifikojnë për komunitetet tona, dhe shohim hirin e Zotit te nënat dhe baballarët që kanë dy ose tri punë, që t'u japin fëmijëve shansin për një jetë më të mirë, më të begatë dhe më të lumtur", tha ai.

Presidenti Trump foli për ndihmën që miq, të panjohur dhe punonjës së ndihmës së shpejtë e zjarrfikës dhanë pas katastrofave humanitare

dhe ngjarjeve të dhimbshme si sulmi në Las Vegas. Ai foli për fajnë që ndihmojnë. "Së bashku si amerikanë, ne jemi një forcë e palodhur për drejtësi dhe për paqe. Kemi qenë dëshmitarë të kësaj së vërtete gjatë vitit të kaluar. Për vite me radhë, ISIS kishte torturuar dhe vrarë brutalisht të krishterë, hebrej, pakica fetare dhe shumë myslimanë. Sot koalicioni kundër ISIS-it ka çliruar pothuajse 100 të territorit që deri vonë ishte nën kontrollin e këtyre vrasësve në Irak dhe në gjithë Sirinë", tha presidenti.

Duke përmendur njerëzit që vuajnë të shtypur në Iran, Kubë, Venezuelë, Korenë e Veriut dhe vende të tjera, presidenti Trump tha se Amerika është gjithmonë në krah të atyre që janë të shtypur dhe vuajnë përmdejkje për arsye fetare.

Në ceremoninë e sotme, morën pjesë udhëheqës dhe politikanë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Në fillim të ceremonisë, me të tjerëve u vlerësua praninë e udhëheqësve të Kosovës.

Mëngjesi kombëtar i Lutjeve, i organizuar nga Fondacioni për Miqësinë, mbledh çdo vit mijëra vetë nga e gjithë bota dhe tërheq veçanërisht evangjelistët.



SKËNDERBEU DHE MARIN BARLETI



Feride PAPELEKA

Humanist i shquar dhe historian, Barleti është i pari autor i njohur dhe një nga më të mëdhenjtë e letërsisë së hershme shqipe. Vepra e tij "Historia e Skënderbeut" u shkrua në latinisht dhe, siç thotë F. Palle, u përkthye pothuaj në të gjitha gjuhët e Evropës sepse, në të vërtetë, lufta çlirimtare e arbërorëve, të udhëhequr prej Skënderbeut, sipas mendimit politik të njerëzve më të qartë të kohës, kishte një funksion evropian, e cila gjeti shprehjen te ideja për një front të gjerë kundërosman, që mbeti në letër nga politika e mbyllur e disa shteteve. Pas rreth 500 vjetësh, më 1965, kjo veprë u dha edhe publikut shqiptar në gjuhën shqipe, në gjuhën amtare të autorit, me përkthimin mjeshëtor të Stefan I. Priftit. Duke na njohur me një të kaluar të lavdishme, vepra është edhe një dëshmi e zjarrtë atdhedashurie e shqiptarizmi, burimi kryesor i një literature të gjërë dhe veprash artistike në pikturë, në skulpturë, në muzikë dhe në kinematografi. Me emrin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut lidhen identiteti ynë dhe krenaria jonë kombëtare. Lavdia e tij ka qenë përherë simbol qëndresë në vitet e rënda e të gjata pesëshekullore të robërisë turke. Kujtimi i tij i ndrojtur rilindësit për realizimin e epopesë së zgjimit kombëtar për pavarësi dhe emancipim historik. Emri i tij është simbol i përjetshëm frymëzimi.

Cili ishte Marin Barleti?

Për jetën e tij nuk ekzistojnë shumë të dhëna, ato i mësojmë kryesisht përmes veprave që ka botuar, në të cilat kur e sjell rasti, ai flet edhe për veten. Barleti lindi në Shkodër. Këtë e pohan në krye të librave të tij, kur thotë: "Marin Barleti, prift shkodran". Në fillimet e adoleshencës përjetoj rrethimin e parë të qytetit (1474). "Kështu më kujtohet se në Rrethimin e Parë të Shkodrës armiqtë u dukën rrëzë mureve gati më parë se të merrnim vesh për ta" (Historia e Skënderbeut, IV, 229). Ndërsa më 1478-1479, gjatë rrethimit të dytë, ai bënte pjesë në garnizonin mbrojtës të kështjellës. Për këtë bastion të fundmë të qëndresës shqiptare ai thotë se ka luftuar me armë në dorë, i frymëzuar nga lavdia e Skënderbeut për të mbrojtur atdheun, "por pa fat" (VI, 339). Në kreun e trembëdhjetë, apo librin e trembëdhjetë sipas Barletit që është edhe epilogu i veprës Historia e Skënderbeut, ai njofton se ka botuar edhe një "librezë" për

Rrethimin e Shkodrës.

Pas tragjedisë së rënies së Shkodrës më 1479, që shënon edhe rënien e krejt Shqipërisë, Barleti i ri mori rrugët e mërgimit përtej detit me luftëtarët që kishin mbetur, duke ruajtur në shpirt kujtimin e prindërve që iu vranë gjatë rrethimit dhe emrat e atyre që kishin rënë në atë luftë të pabarabartë. Më 1479 dhe 1480 u arratis në dhe të huaj gjithë popullata e qytetit që nuk duronte dot të jetonte në robëri. "Banorët e tij u larguan pothuajse të gjithë [...] (Histori e Shqipërisë, Tiranë 1973, f. 67). Dhe është paradoksale kur dëgjon ndonjë studiuës të fushës së historisë mesjetare shqiptare që guxon të pohojë se "turqit nuk kanë qenë pushtues, por administratorë". Kjo është jashtë së vërtetës historike po të lexojmë në vetë kronikat osmane vrasjet, shkatërrimet dhe djegiet e panumërta deri në shkretim të krahinave ku shkelte pushtuesi. Dihet se Skënderbeu i fitoi të gjitha betejat kundër ushtrive osmane, që nga ajo e Torviollit (qershor 1444) e deri në atë të Albulenës (shtator 1457), që nga ajo e rrethimit të parë të Krujës (verë 1450) e deri në rrethimin e saj të tretë (korrik 1467), gjithsej njëzet e pesë beteja, përveç asaj të Beratit korrik (1455), në të cilën për një rastësi fatkeq Skënderbeu nuk mori pjesë (shkak u bë një armëpushimi i imponuar); humbja aty që aq e rëndë sa pothuaj të gjithë komandantët shqiptarë u zunë rob dhe u masakruan. Të mos harrojmë se çdo fitore ka pasur dëshmorët e saj, humbje jetësh të paktyshme dhe dëme të mëdha; vetëm në Torvioll që mbahet si beteja me më pak humbje, numri i të vrarëve ishte 1600 ushtarë dhe komandantë, i cili u bë 2000 me 400 te tjerët që u plagosën rëndë dhe vdiqën pas një kohe të shkurtër. Por gjithë kjo gënjeshtrë bën pjesë në fushatën strategjike për të shtrembëruar çdo të vërtetë, në mënyrë që ky popull mos të gjejë kurrë qetësi e të realizohet qëllimi famëkeq për zhbërjen e identitetit kombëtar shqiptar.

Në Venedik, Barleti kreu studime teologjike, kuptohet, i ndihmuar ekonomikisht për të përballuar jetën edhe nga fakti se Shkodra kishte qenë zotërim i Republikës së Venedikut dhe ai gëzonte të drejtën si qytetar i saj. Pas diplomimit punoi si prift në rrethinat e Republikës. Me dije të thella për letërsinë dhe filozofinë greke e latine, ai u pajis me kulturë humaniste dhe e zotëronte aq mirë latinishten, sa arriti t'i shkruante veprat në këtë gjuhë. Jeta e përbashkët me të mërguarit shqiptarë, mes të cilëve kishte edhe nga ata që kishin qenë bashkëluftëtarë të Skënderbeut, e ndihmoi të njihje gjerësisht me kujtimet për heronin dhe për epokën e qëndresës shqiptare ndaj pushtuesve osmanë e të plotësonte kështu me fakte veprën Historia e Skënderbeut, të cilat i pasuroi pastaj edhe me të dhëna nga historia e botës, nga

letërsia dhe nga mitologjia.

Barleti pohan se ka i ka përjetuar fort të dyja rrethimet e Shkodrës, 1474 dhe 1478. Për rrethimin e dytë ai ka shkruar veprën Rrethimi i Shkodrës, duke mbetur kështu historiani i parë shqiptar dëshmitar sypamës, ashtu si e përkthen Noli fjalën "okular" i një lufte të një ushtrie të vogël, me ushtrinë e një prej perandorëve më të fuqishme të kohës. Ky libër është botuar më 1504. Më në fund si datë vendimtare është edhe vepra e tretë, në të cilën flitet për papët deri në vitin 1512. Nga kjo e dhënë e fundit merret vesh se ai është ndarë nga jeta përafërsisht kur ndalet vepra për jetëshkrimin e papëve, rreth 1512 ose 1513-s. Mendohet se ka lindur rreth vitit 1460 në Shkodër dhe ka vdekur rreth viteve 1512 ose 1513 në Padova. Sipas gjuhëtarit të shquar Eqrem Çabej, Barleti vjen nga trajtja shqipe Bardheci. Këtë e dëshmon edhe Thalozcy në librin Gjurmime iliro shqiptare. Madje në tri botimet e para të librit Rrethimi i Shkodrës, shënohet Barleci.

Prej Marin Barletit njihen tri vepra: 1) De obsidione Scodrensi (Rrethimi i Shkodrës, Venedik, 1504), në të cilën përshkruhet historia dramatike e luftës për jetë a vdekje të banorëve të rrethuar për një vit nga Osmanët. Vepra pati edhe tri ribotime të tjera më 1576, 1578, dhe më 1596. Në shqip u përkthye më 1964 nga Henrik Lajçaj.

2) Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis (Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, princit të Epirotëve), Romë, midis viteve 1508-1510, të cilën i janë bërë jo vetëm shumë

ribotime në gjuhën e originalit, latinisht, por në fillim të shekullit XVI edhe ribotime nga përkthimet në gjuhët kryesore të Europës si gjermanisht (1533), italisht (1554, 1560), portugalisht (1567), polonisht (1569), frëngjisht (1576), spanjisht (1582), anglisht (në fund të shekullit)... Përkthimit shqip, në vitin 1965, i janë bërë dhe tri ribotime të tjera para '90-s si dhe një ribotim, pas vitit 90.


3) Compendium vitarum summorum pontificum imperatorumque Romanorum (Pasqyrë e shkurtër e jetës së papëve dhe perandorëve romakë, Romë, 1553...; kjo veprë i kushtohet Pjetër Engjëllit, njërit prej bashkëluftëtarëve kryesorë të Gjergj Kastriotit, i cili e pati nxitur dhe ndihmuar autorin për të shkruar një histori për Skënderbeun.

Barleti historian

Vepra e dytë dhe më e rëndësishme e Barletit si historian është Historia e Skënderbeut, e cila u bë shumë shpejt e njohur gati në të gjithë Evropën nëpërmjet përkthimeve dhe pati jehonë si veprë me frymë të lartë humaniste. Përkthyesi i saj në shqip, e ka shoqëruar tekstin me një studim të admirueshëm për veprën dhe vlerat e saj historike e stilistike. Ai e ka pajisur atë edhe me shënime sqaruese për ngjarje dhe figura të ndryshme, duke e bërë më të kuptueshëm për lexuesin e sotëm: "Katërqind e pesëdhjetë vjet më parë Barleti ynë shkroi në gjuhën latine sipas zakonit, veprën e tij monumentale për Gjergj Kastriotin, "Historinë e Skënderbeut". Në faqen e parë titulli zgjerohet me një nëntitull: Mbi

sjelljet e jetës dhe punët, veçanërisht kundrejt turqve, bëmat e Gjergj Kastriotit, princit i shkëlqyer i epirotëve, i mbiquajtur Skanderbeg për veprat e tij, ndryshe Aleksandri i Madh. Shkruar prej Marin Barlet Shkodranit... (lat. De Vita Moribus Ac Rebus Praecipue Aduersus Turcas, Gestis, Georgii Castrioti, Clarissimi Epirotarum Principis, qui propter celeberrima facinora, Scanderbegus, hoc est, Alexander Magnus, cognominatus fuit, libri Tredecim, per Marinum Barletium Scodrensem conscripti...).

Në parathënien, Barleti na njehe me konceptin e tij të drejtë për historinë si shkencë, e cila mbështetet te e vërteta. "[...] Rregulli dhe ligji i historisë është që, kur shumë gjëra të gabuara janë të përziera me të vërteta, të rrihen e të shoshiten mirë, me qëllim që të pastrohen si në ujë të kulluar përrensh dhe të ngelin të lagarta për ata që do të lexojnë këto shkrimet tona" (VII: 380). Ai mendon se është shumë e rëndësishme që e kaluara të mos gjykohet me sytë e së tashme, duke iu kushtuar njëkohësisht shumë rëndësi të dhënave, të cilat duhet të jenë "të padyshimta" e "të besueshme", në mënyrë që të ishte objektiv për lexuesin. Të tilla janë ato që ai ka parë vetë, pra, i ka përjetuar dhe mbi të cilat është mbështetur në veprën e parë Rrethimi i Shkodrës, por të besueshme ai i quan edhe kujtimet e pashlyeshme të atyre që kanë qenë bashkëluftëtarë të Skënderbeut e mbi të cilat ai është mbështetur për të shkruar veprën Historia e Skënderbeut. Një ndër ata ka qenë edhe Pjetër Engjëlli, pjesëmarrës në epopëne e Skënderbeut, i cili i siguroi "shumë të dhëna të sakta". Vëllai i tij Pal Engjëlli, kryepeshkop i Durrësit dhe hartues i qarkores Formula e pagëzimit (1462) në gjuhën shqipe, ka qenë njëkohësisht edhe bashkëpunëtor i Skënderbeut për çështjet diplomatike. Kur thënie të bashkëluftëtarëve të Skënderbeut përputhen me përfundimin e ngjarjeve, autori është i bindur se i është afruar të vërtetës. Në raste të ndërlikuara ai e lë të vërtetën në dorë të lexuesit të ardhshëm, të paanësia e tij: "Megjithëkëtë, paanësia e lexuesve [...] le ta nxjerrë gjithë të vërtetën nga shqyrtimi i kujdesshëm i rrethanave të kohës" (III: 175). Ai që në fillim shkruan "barra që kam marrë përsipër më rëndon e më tremb [...], padashur mua po më rëmben prej kohësh kjo dëshirë [...] kam pritur me shpresë e me zjarr në zemër që kjo lëndë kaq e gjërë të nxiste ndonjë shkrihtar [...] Por asnjëri deri tani s'e ka pëlqyer një mund kaq të shenjtë, megjithëqë nuk pushojnë së botuari çdo ditë kujtime të panumërta deri në shpërdorim" (Parathënie: 59, 60). Sidoqoftë Barleti është i bindur "se më pas do të jenë të shumtë ata që do të provojnë të hyjnë në rrugën e hapur [...]". (Parathënie: 61). (Fusnotat i ka hequr redaksia. Vjion)



E rralë

Fshati i jetëgjatëve

Antonio Todde ishte njeri i parë në botë që u dokumentua se jetoi deri në moshën 110-vjeçare. Ai banonte në Tiana, një fshat në ishullin italian të Sardenjës. Lindi në vitet 1800 e vdiq në vitin 2002. "Jeta e tij u shtri tre shekuj!", tregon i biri, Tonino, 84 vjeç, i cili shpreson ta arrijë moshën 100-veçare. Tiana është fshati në të cilin banorët jetojnë më së gjati.



FOTO E DITES



Priftërinjtë nga Nepali mbajnë ujë të shenjtë nga përroi i lumenjve Ganges, Yamuna dhe Saraswati. /AFP/

E jashtëzakonshme

Çifti martohet në një lartësi mbi 121 metra

Ryan Jenks dhe Kimberly Weglin martesën e tyre e kurorëzuan mbi kanionin Utah, mbi 121 metra lartësi. Çifti qëndroi në një rrjetë rezistence prej 600 metrash katrorë. "Na pëlqen të dyle ecja mbi litar dhe këtë e kthym në pjesën më të rëndësishme të jetës sonë", është shprehur dhëndri.



BARSOLETA E DITËS



Djali: A pranon të lidhesh me mua?
Vajza: Jo.
Djali: A dëgjoje çfarë të thashë?
Vajza: Po.
Djali: Çfarë të thashë?
Vajza: A pranon të lidhesh me mua?
Djali: Po, me gjithë qejf.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

"FERDINAND"

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.
 Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.
 Regjia: James Foley

Në ora 22:00 (PG-13)

"THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Keni zgjedhur një rrugë të

mesme sot për t'i arritur objektivat tuaj. Edhe pse do të keni kritika, jeni ju që merrni vendimet për veten.



DEMI
Po hidhni argumente që nuk jeni

të gatshëm t'i mbështesni në ditët në vazhdim. Mbase një ndryshim strategjie do të ishte më i mirë.



BINJAKËT
Puna për ju sot do të jetë një burim

kënaqësie. Bashkëpunimi me kolegët ju ka bërë që të përfitoni bonuse mjaft të mira morale dhe materiale.



GAFORRJA
Po lini pas dore raportet

tuaja personale, sidomos ato që u përkasin ndjenjave. Kur t'i kërkonit miqtë tuaj do të vini re distancat.



LUANI
Nëse nuk jeni të kënaqur

nga ajo që po bëni kohë e fundit, është mirë të ndaleni dhe të mendoni qartë se cili është prioriteti juaj.



VIJGJËRËSHA
Doni t'i vazhdoni projektet

që keni nisur, por rrethanat nuk do t'ju lejojnë ta bëni këtë gjë. Ndryshoni drejtim në kohën e duhur.



PESHORJA
Gjëja më e mirë është heshitja kur

shihni se përreth jush situatat dhe personat janë duke krijuar rrëmuje. Më pas gjithçka do të qartësohet.



AKREPI
Personat gri që rrinë rreth jush

nuk kanë pasur asnjëherë ide dhe nuk ju kanë propozuar asgjë deri tani. Bëni mirë të bëni dallime.



SHIGJETARI
Sot duhet të veproni vetëm për veten tuaj.

Duke marrë rolin e të tjerëve i keni hequr vetes mundësitë të dëgjoheni në ambiente të ndryshme.



BRICJAPI
Jeni të pavarur në vendimet

tuaja sot dhe kjo ju ka krijuar mjaft liri veprimi. Përfitimet e kësaj gjeje do t'i përjetojnë edhe familjarët tuaj.



UJORI
Keni kërkuar prej kohësh mënyrën më

të mirë për të zgjidhur disa ngërçe që po verifikohen në ambientin e punës. Nëse nuk ia dilni, mbase është momenti të ndaloni.



PESHQIT
Entuziazmin e munguar po filloni ta

gjeni përsëri sot në detaje të vogla dhe në ambientin e ngrohtë familjar.

Kylie Jenneri mund Beyoncen



Kim Kardashian mund të ketë më shumë ndjekës në rrjetin social "Instagram", por tani duket se motra e saj Kylie Jenner është mbretëresha e këtij rrjeti social. 20-vjeçarja ka thyer rekordin e Beyonces

me fotografinë më të pëlqyer ndonjëherë. Fotografia e foshnjës së saj Stormi, ku Kylie konfirmoi edhe emrin e vajzës për herë të parë, është pëlqyer nga më shumë se 14.8 milionë persona.



Dua Lipa gjatë këtij viti me turne edhe në Azi

Superylli shqiptar, Dua Lipa, ka krijuar popullaritet në mbarë botën. E një popullaritet i shprehur i saj vërehet në të gjitha pjesët e botës, madje edhe në Azi.

Bukuroshja nga Prishtina gjatë muajit maj do të mbajë disa koncerte, edhe në Kore të Jugut (Seul) dhe në Japoni (Tokio). Më 6 maj ajo performon në Seul, kurse më 8 maj në Tokio.

Lyrical Son dhe Gresa bëjnë pushime me vajzën në Meksikë



Reperi i njohur Lyrical Son ka premtuar se këtë vit do të jetë shumë produktiv në muzikë. Lyrical Son dhe bashkëshortja e tij Gresa kanë vendosur t'i japin vetes disa ditë të merituar pushimi. Ata

kanë shkuar në Meksikë për ta shijuar plazhin dhe motin e ngrohtë, bashkë me vajzën e tyre, Evën. "Pushime në Meksikë me më të dashurit e mi", ka shkruar Gresa në rrjetet sociale në mbishkrimin e fotografisë.

Jim Carrey paralajmëron se do ta mbyllë llogarinë në "Facebook"



Jim Carrey ka njoftuar përmes llogarisë personale në "Twitter" se po planifikon të heqë dorë prej "Facebook"-ut. Ai ka thënë se do t'i shesë aksionet që ka në këtë rrjet social. "Jam duke nxjerrë në shitje

aksionet e mia në 'Facebook' dhe do ta mbyll llogarinë time, sepse 'Facebook'-u ka përfituar nga ndërhyrja e Rusisë në zgjedhjet tona dhe ende nuk kanë bërë mjaftueshëm për ta ndaluar atë", ka shkruar Jimi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Ehivert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ATHLETIC BILBAO - LAS PALMAS

GG3+

MILLWALL - CARDIFF

GG3+

LEIPZIG - AUGSBURG

GG3+

Flamuri i Kosovës u ngre në PyeongChang, sot parakalimi historik

Flamuri i Kosovës është ngritur të enjten në PyeongChang, kurse sot (e premte) do të bëhet parakalimi historik i Kosovës. Lidhur me pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë Dimërore, Albin Tahiri për "Epokën e re" ka deklaruar: "Objektivat e mia janë së pari t'i prezantoj ngjyrat e Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme dhe t'i bëj krenarë njerëzit e mi, pastaj t'i tregoj botës se edhe ne mund të jemi pjesë e garave të mëdha. Dua të dëshmoj se jemi gati edhe për sporte dimërore sikurse në sportet verore. Të flasim për rezultatet e sakta është e vështirë tani, sepse të skijosh në alpe, kushtet janë të ndryshme dhe konkurrenca është e madhe".



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Flamuri i Kosovës të enjten në një atmosferë solemne është ngritur në Fshatin Olimpik në PyeongChang, ku po qëndron ekipi olimpik i Kosovës për Lojërat Olimpikë Dimërore "PyeongChang2018". Ekipit të Kosovës i ka prirë presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani, i cili ka shkëmbyer dhuratat me kryetarin e Fshatit Olimpik, Yeo Hyeung-Koo, si dhe është nënshkruar në Murin e Paqes.

Presidenti Hasani ngritjen e flamurit e ka quajtur moment historik për shtetin e Kosovës. "Pa dyshim se është ndjenjë e veçantë sepse këtu në PyeongChang po ndodh historia e sportit të Kosovës, pasi për herë të parë po marrim pjesë në Lojërat

Olimpikë Dimërore. Si çdo qytetar tjetër po ndihem mirë edhe unë. Po marrim pjesë me Albin Tahirin, i cili ka fituar normën olimpikë në pesë disiplina", ka thënë Hasani.

Krahas flamurit të Kosovës, të enjten është bërë ngritja edhe e flamurit të Islandës, Ganës, Ekuadorit dhe Lihtenshtajnit. Ndërsa sot (e premte) do të bëhet hapja zyrtare e Lojërave Olimpikë Dimërore, kurse ekipi olimpik i Kosovës do ta bëjë parakalimin historik. "Flamuri i Kosovës për herë të parë do të parakalojë në LOD, falë skitarit Albin Tahiri, i cili ka fituar normën olimpikë në pesë disiplina të skijimit alpin. Ceremonia hapëse do të fillojë në orën 12:00 me kohën tonë lokale, kurse me kohën koreane në orën 20:00. Ceremonia pritet të zgjasë dy orë, kurse Kosova pritet të parakalojë pas orës 13:00. Ekipi olimpik i Kosovës që do të parakalo-

jë përbëhet nga bartësi i flamurit, Albin Tahiri, trajneri i tij, Agim Pupovci, shefi i misionit, Bujar Turjaka dhe zyrtari për media, Kushtrim Krasniqi", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Sportisti i vetëm që e prezanton Kosovën në këto lojëra, Albin Tahiri, për "Epokën e re" ka thënë se do të përpiqet t'i prezantojë sa më mirë ngjyrat e shtetit të Kosovës. "Objektivat e mia janë së pari t'i prezantoj ngjyrat e Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme dhe t'i bëj krenarë njerëzit e mi, pastaj t'i tregoj botës se edhe ne mund të jemi pjesë e garave të mëdha. Dua të dëshmoj se jemi gati edhe për sporte dimërore sikurse në sportet verore. Të flasim për rezultatet e sakta është e vështirë tani, sepse të skijosh në alpe, kushtet janë të ndryshme dhe konkurrenca është e madhe", ka thënë Tahiri.

SHKURT

Federata e Mundjes, turne për ditën e pavarësisë

Federata e Mundjes e Kosovës (FMK) do ta organizojë turneun e katërt mbarëkombëtar "Trofeu i Pavarësisë". Ky turne do të mbahet më 16 shkurt, kurse pjesëmarrës në të do të jenë ekipet nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Turne mbahet për grupmoshën e juniorëve në këto kategori: 57, 61, 65, 70, 74, 79, 86, 92, 97 kg, tolerancë 2 kg.

Liria - Rahoveci, 1-1

KF Liria dhe KF Rahoveci kanë luajtur baras (1-1) të enjten në një ndeshje miqësore në Prizren. Golin e vetëm për prizrenasit e shënoi Zeka, kurse për mysafirët nga Rahoveci shënoi Dushi. Duhet cekur se Liria në këtë ndeshje ishte pa Korenicën, Bakajin dhe Toungaran për shkak të lëndimeve.

Bajrami lë Vllazninë për Gostivarin

Jasir Bajrami ka konfirmuar largimin nga KF Vllaznia e Pozheranit. Karrierën futbollistike Bajrami pritet ta vazhdojë në skuadrën e Gostivarit. "Edhe zyrtarisht jam pjesë e Klubit 'KF Gostivari'. Falënderoj kryesinë për besimin e dhënë. Shpresojmë në suksese. E falënderoj ish-klubin, Vllaznia Pozheran, kryesinë e klubit, qytetarët e Pozheranit, pa harruar tifozët 'Tigrat' që na mbështetën në çdo lojë dhe ato emocione të paharruara gjatë lojës historike të Klubit Vllaznia. Ju uroj shumë suksese të tjera. Faleminderit për gjithçka", ka shkruar Bajrami në "Facebook".

Unitedi dhe Arsenalu e duan Hysajn

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj, mund të luajë nga sezoni i ardhshëm në Premier Ligë. Forma e mirë e shfaqur me fanellën e Napolit ka ndikuar që Manchester Unitedi dhe Arsenalu të tregojnë interesim për transferimin e tij në afatin kalimtar të verës. "Arsenal dhe Manchester Unitedi synojnë ta kenë në skuadër gjatë verës mbrojtësin e Napolit, Elseid Hysaj", ka shkruar faja "talkSPORT".

Nachevski ligjëron para fillimit të edicionit pranveror 2017/18

Sot (e premte) mbahet këshillimi për gjyqtarë, vëzhgues-kontrollues, trajnerë të hendbollit dhe përfaqësues zyrtarë të klubeve. Këshillimi, përkatësisht seminari qendror, mbahet nga ora 15:00 në Prishtinë, në ambientet e Fakultetit Filozofik (amfiteatri numër 5, karshi Bibliotekës Kombëtare). Ligjëruer në seminar do të jetë lektori nga Federata Evropiane e Hendbollit, Dragan Nachevski. Kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve të Hendbollit të Kosovës, Fahredin Hashani, ka njoftuar se do të ligjërohet për ndryshimet në rregullat e hendbollit dhe praktikumin e tyre. Seminarin e organizojnë Federata e Hendbollit e Kosovës në bashkëpunim me ShGJhK-në para fillimit të edicionit pranveror i cili do të fillojë më 17/18 shkurt 2018 në Superligën e meshkujve. Pjesëmarrja është e obliguar për të gjithë gjyqtarët dhe vëzhguesit-kontrolluesit që janë pjesë e listës për edicionin aktual 2017/18. Mospjesëmarrja nënkupton mospërfshirje në delegim për stinorin pranveror.

Prekazi: Jemi mobilizuar për titull

DRENAS, 8 SHKURT - Mbrojtësi i Feronikelit, Arbër Prekazi, ka thënë se skuadra nga Drenasi është mobilizuar për të luftuar deri në fund për titullin e kampionit. Ai më pas bëri me dije

se ish-kampionët e Kosovës në ndeshjen e parë që do ta zhvillojnë ndaj Dritës, në kuadër të javës së 19-të të Vala Superligës, do të shkojnë për fitore. "Normalisht se do të shkojmë

për të fituar ndaj Dritës. Megjithatë, në rast të ndonjë barazimi, ne nuk do të dorëzohemi deri në fund. Ka pasur raste në kampionatet e kaluara kur ekipet që ishin nëntë pikë

prapa liderit kanë arritur të shpallen kampionë. Ne jemi mobilizuar mjaft shumë që ta ndjekim deri në ndeshjen e fundit titullin e kampionit", ka thënë Prekazi.



Bach: Gjithçka gati për Olimpiadën, presim vetëm ceremoninë e hapjes

PYONGYANG, 8 SHKURT - Në Korenë e Jugut po mbyllen përgatitjet e fundit për të nisur Lojërat Olimpikë Dimërore "Pyeongchang 2018", ku më 9 shkurt do të zhvillohet ceremonia e hapjes.

Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, ka siguruar të gjithë se gjithçka është gati. "Nuk ekziston asnjë problem teknik. Gjithçka është gati. Tani na ka mbetur vetëm një gjë për të bërë, ta fillojmë Olimpiadën", u shpreh Thomas Bach.

Më tej, numri një i olimpizmit botëror u shpreh i kënaqur që dy Koretë do të parakalojnë nën të njëjtin flamur në ceremoninë e hapjes, madje do të kenë një skuadër të përbashkët në sportin e hokejit për femra. "Për mua do të mbetet një moment historik dhe emocionues, duke qenë se edhe unë në të shkuarën kam garuar me dy shtete të ndryshme, për



një vend të ndarë, siç ka qenë Gjermania", ka deklaruar Bach, referuar ndarjes së Gjermanisë Lindore dhe asaj Perëndimore, raporton "Telesport". Në fund, Thomas Bach ka dhënë edhe një mesazh tjetër për sportin rus dhe skandalin doping që ka pushtuar këtë vend, që ka sjellë edhe përkrahimin e Rusisë nga çdo ngjarje

ndërkombëtare dhe olimpikë. "Sportistëve të akuzuar për doping nuk do t'u lejohej të garojnë në Olimpiadë. Rregullat janë të qarta. Ata që janë lejuar janë të pastër dhe do të garojnë si neutralë, duke firmosur një deklaratë dhe pakt me ne, të cilat do t'i monitorojmë deri në fund", ka shtuar Bach.

James, vendimtar në fitoren e Clevelandit

